



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:142591

Datë: 14.11.2022

Numri i dokumentit: 03641164

PKR.nr.144/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.Rr. për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.196/22 të dt. 09.08.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, me datë 07.11.2021, në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani dhe të pandehurit D.Rr. në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.14.11.2021 përpiloi këtë merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

D. RR., i biri idhe nënës, e gjinisë i lindur me dt. në, me vendbanim ne fsh., ... K-, ka të kryer shkollën e mesme, me nr. personalë, i pa punë, i pa martuar, posedues i nr. tel, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë ka siguruar dhe gjerë me dt.28.06.2022 rreth orës 17,30 minuta, në mënyrë të pa autorizuar dhe në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit mbi armë (Ligji Nr.05/L-022) ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një pistoletë të prodhimit Ç.cal.7.65 m.m., me numër serik, me ngjyrë të zeze. së bashku me një karikator dhe shtatë fishek të cal.7.65 m.m., më mbishkrim P.. , e të cilën armë dhe municion e kanë sekuestruar nga i pandehuri hetuesit Policor me dt.28.06.2022, pasi që rreth orës 17,30 minuta pasi policët kishin ndaluar të pandehurin gjersa ishte duke e drejtuar veturën e tij për kontroll rutinore i pandehuri tenton të iu shmanget policëve dhe gjatë ikjes në një rrugicë afër qendrës zejtare e hedhë në tokë çantën e krahut në të cilën

kishte pasur armën e lartcekur e të cilën armë dhe municion e sekuestrojnë hetuesit policor në vendin e ngjarjes,

-me çka ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 dhe 366 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin D.Rr. e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind)euro, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të, shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të, taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 366 par 3 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet një pistoletë të prodhimit Ç.cal.7.65 m.m., me numër serik, me ngjyrë të zezë. së bashku me një karikator dhe shtatë fishek të cal.7.65 m.m., me mbishkrim P.. .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.196/22 të dt. 09.08.2022, ndaj të pandehurit D.Rr. për shkak të veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve” nga neni 366 par.1, të KPRK-së .

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 07.11.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe prezentë kane qene Prokurori i Shtetit Agron Galani dhe i pandehuri D. Rr..

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për

pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ka shprehur pendimin për veprën e kryer dhe ka premtuar së më nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Kryetari i trupit gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje më shkresat e lëndës.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raportit Informues të hetuesit V.Gdt.28.06.2022, deklarata e të pandehurit të dhënë në Polici me dt.28.06.2022 dhe në prokurori me dt.09.07.2022 ku ai ka pranuar se ka kryer veprën penale për të cilën pandehet, Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve – armës nga i pandehuri D. dt.28.06.2022, listës së dëshmimeve dt.22.06.2022 dhe fotografive e armës së sekuestruar, si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedhë së në veprimet e të pandehurit D.Rr. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori, pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimi për veprën e kryer, premtimin se në te ardhmen nuk do te kryej vepra tjera penale, faktin se i pandehur me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, konfiskohen një pistoletë të prodhimit Ç.cal.7.65 m.m., me numër serik, me ngjyrë të zezë. së bashku me një karikator dhe shtatë fishek të cal.7.65 m.m., me mbishkrim P.. .

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda,
PKR.nr.144/22, dt. 14.11.2021.**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.